

## Vlera e adhurimeve vullnetare

﴿ فضل النوافل ﴾

[ Shqip – Albanian – ألباني ]

**Përktheu:** Fatmir Latifi

**Redaktoi :** Driton Lekaj

2009 - 1430

islamhouse.com

## ﴿ فضل النوافل ﴾

[ شqip – Albanian – ألباني ]

ترجمة: فاطمير لاتيبي

مراجعة: دريتون ليكاي

2009 - 1430

islamhouse.com

## Vlera e adhurimeve vullnetare

**Shenjat e dashurisë së Allahut ndaj robit të Tij si dhe mënyra e realizimit të kësaj dashurie:**

Allahu i lartësuar thotë:

“Thuaj: "Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë.” (Ali Imran: 31)

- Ebu Hurejra thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kur Allahu i Madhëruar e donë robin (e vet) e thërret Xhibrilin dhe i thotë: Vërtet Allahu e donë filanin, andaj duaje edhe ti, dhe Xhibrili e do. Pastaj e shpall te banorët e qiellit: Vërtet Allahu e do filanin, andaj dojeni edhe ju. Pastaj, banorët e qiellit e duan dhe i vendoset pranim në tokë." (Mutefekun alejhi).

- Ebu Hurejra thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kushdo që tregon armiqësi ndaj mikut Tim unë do ti shpalli luftë. Me asgjë robi im nuk mund më mire të më afrohet pos me atë me çfarë Unë e kam obliguar (farzet) dhe vazhdimisht robi im më afrohet me vepra vullnetare (nafile), derisa Unë ta dua, e kur ta dua, Unë bëhem veshi i tij me të cilin dëgjon; syri i tij me të cilin sheh; dora e tij me të cilën sulmon fuqishëm; këmba e

tij me të cilën ecën. E nëse më kërkon diçka, do t'ia jap, e nëse kërkon mbrojtje nga Unë ,do ta mbroj atë." (Buhariu).

**Disa prej llojeve të veprave vullnetare me të cilat robi arrin këtë shkallë të dashurisë**

### 1) **Leximi i Kuranit Fisnik.**

- Ebu Umame thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Lexojeni Kuranin, vërtetë ai do të ndërmjetësoj Ditën e Gjykimit për ata që e lexojnë "(Muslimi)

- Uthman ibën Affan thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Më i miri prej jush është ai i cili mëson Kuran dhe ia mëson atë dikujt". (Buhariu)

- Abdullah ibn Mesudi thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kush e lexon një shkronjë prej librit të Allahut atij i takon një e mire, e ajo e mire shpërblehet dhjetëfish. Nuk u them juve se Elif-Lam-Mim është një shkronjë por, Elifi është shkronjë, Lami është shkronjë dhe Mimi është shkronjë." (Tirmidhiu)

### 2) **Vlera e Dhikrit.**

- Allahu i lartësuar thotë: "Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime ), Unë ju kujtoj juve (me shpërblim)...". (Bekare:152)

Dhe Allahu i lartësuar thotë: "...por, edhe përmendeni shpesh Allahun, ashtu që të gjeni shpëtim."(Xhumuah:10)

- Ebu Hurejra thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kush thotë: **La ilahe il-Allah** vahdehu la

**sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kuli shejin kadir.**

(S'ka të adhuruar përveç Allahut, Një dhe i Pashoq, Atij i takon sundimi dhe lavdërimi. Ai është i plotfuqishëm mbi çdo gjë.)

Kush e thotë këtë njëqind herë në ditë ka shpërblim sikur t'i ketë liruuar dhjetë robër. Atij i shkruhen njëqind të mira, i fshihen njëqind mëkate dhe është i mbrojtur nga djalli deri në mbrëmje, askush nuk ka vepruar më mirë se ky person, me përjashtim të atij që ka vepruar më tepër." (Muttefekun alejhi)

- Dhe thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "**Kush thotë SubhanAllahi ve bihamdih**".

(I Lartësuar qoftë Allahu, Atij të cilit i takon lavdërimi) njëqind herë në ditë i fshihen mëkatet e tij edhe në qoftë se janë sa shkuma e detit." (Muttefekun alejh).

- Dhe thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kush thotë SubhanAllah tridhjetë e tri herë, kush thotë Elhamdulillah tridhjetë e tri herë dhe kush thotë tridhjetë e tri herë Allahu Ekber, e pastaj e plotëson këtë me të njëqindtën: **La ilahe il-Allahu vahdehu la sherike leh ,lehul mulku velehul hamdu ve huve ala kulishejin kadir**, do ti falen mëkatet qofshin ato edhe sa shkuma e detit." (Muslimi)

- Sa'd ibn Ebi Vekasi thotë: Ishim te i Dërguari ( paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i cili tha: "A nuk ka mundësi ndonjëri prej jush që të fitoj çdo ditë njëmijë të mira? Atëherë një prej të pranishmeve pyeti: Si i fiton njëmijë të mira? I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut

qofshin mbi të) tha :Thotë njëqind herë Subhanallah dhe i shkruhen atij njëmijë të mira ose i fshihen atij njëmijë mëkate.”(Muslimi)

### 3) **Prej namazeve vullnetare.**

#### a) **Sunetet e rregullta**

- Nëna e besimtareve Umi Habibe thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke thënë: ”Myslimani që i falë dymbëdhjetë rekate namaz vullnetar (nafile) e që Allahu të mos ia ndërtoj një shtëpi në xhenet ose që të mos i ndërtohet një shtëpi në xhenet.”(Muslimi)

- Nëna e besimtarëve Aisheja thotë: ” I Dërguari iu është përmbajtur dy rekateve të namazit të sabahut më shumë se sa iu është përmbajtur nafileve tjera.” (Muttefekun alejh).

- Dhe thotë se i Dërguari (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: ” Dy rekate të namazit të sabahut janë më të mira se kjo botë dhe çdo gjë që ka në të .” (Muslimi)

- Nëna e besimtareve Umu Habibe thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: ”Kush i fale katër rekate para namazit të drekës dhe katër rekate pas, Allahu do ta ruaj atë prej zjarrit.” (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

#### b) **Namazi i Vitrit dhe namazi i Duhasë**

- Ibn Umeri thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: ”Bëjeni namazin tuaj të fundit vitër (tekë).” (Muttefekun alejh).

- Ebu Hurejra thotë: "Më ka këshilluar miku im (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), që ti agjëroj tri ditë ne çdo muaj, ti fali dy rekate namaz të duhase dhe ta fali vitrin para se të flej." (Muttefekun alejh).

#### **c) Namazi i Tehijjetul Mesxhidit**

- Ebu Katade thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kur të hyn ndonjëri prej jush në xhami mos të ulet derisa mos t'i fal dy rekate." (Muttefekun alejh).

#### **4) Agjërimi Nafie.**

##### **a) Agjërimi i muajit Muharrem**

- Ebu Hurejra thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Agjërimi më i vlefshëm pas Ramazanit, është në muajin e Allahut të Lartësuar Muharrem, kurse namazi më i vlefshëm pas farzeve është namazi i natës." (Muslimi)

##### **b) Agjërimi i ditës së Arafatit dhe Ashuras**

- Ebu Katadeja thotë: Është pyetur i Dërguari i Allahut për agjërimin e ditës së Arafatit, e ai tha: "Agjërimi i arafatit i shlyen mëkatet e vitit të kaluar dhe vitit që ka ngelur." (Muslimi)

- Po ashtu Ebu Katade thotë se është pyetur i Dërguari i Allahut për ditën e ashuras, e ai ka thënë: "Agjërimi i ditës së Ashurasë i shlyen mëkatet e vitit të kaluar." (Muslimi)

**c) Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte:**

- Ebu Hurejra thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Veprat ekspozohen ditën e hënë dhe ditën e enjte, e unë dëshiroj që kur të ekspozohet vepra ime të jem agjërueshëm." (Muslimi)

**d) Agjërimi i tre ditëve të çdo muaji:**

- Abdullah ibn Amër ibn Asi thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Agjërimi i tre ditëve për çdo muaj është agjërim i tërë kohës." (Muttefekun alejhi)

- Ebu Dherri thotë i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Kur të agjërosh tre ditë prej çdo muaji atëherë agjëro të trembëdhjetën, të katërbëdhjetën dhe të pesëmbëdhjetën ditë." (Tirmidhiu).

**5. Umreja (vizita e Qabes).**

- Ebu Hurejra thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Mëkatet e vogla të bëra ndërmjet dy umreve janë të falura, kurse për haxhin e pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç Xhenetit." (Muttefekun alejhi)

- Ibn Abasi thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Umreja në Ramazan është e barabartë me një Haxh apo me një Haxh me mua." (Muttefekun alejhi)



## 6. Prej nafileve madhështore është sadakaja.

- Allahu i lartësuar thotë: "... e çka do që të jepni Ai ua kompenson atë..." (Sebe:39).

- Dhe Allahu i Lartësuar thotë: "Çka do që të jepni nga pasuria e keni për vetën tuaj, po mos jepni për tjetër kë por vetëm për hir të Allahut, e çka do që të jepni nga pasuria u kompensonet në mënyrë të plotë duke mos u dëmtuar ju." (Bekare:272).

- Adij ibn Hatim thotë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Ruajuni prej zjarrit qoftë edhe me një gjysmë hurme." (Muttefekun alejhi)

- Ebu Hurejra thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Nuk ka ditë në të cilën gdhihen robërit e Allahut, e që të mos zbresin dy melekë dhe njeri të thotë: O Allahu im jepi kompensim atij që ka shpenzuar, kurse tjetri thotë : O Allahu im jepi shkatërrim atij që ka shtërnguar doren." (Muttefekun alejh).

- Ebu Hurejra thotë: I Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Shtatë persona Allahu do ti vendos nën hijen e Tij atë ditë kur nuk do të ketë tjetër hije përveç hijes së Tij, e ata janë: Udhëheqësi i drejte, një i ri i cili është rritur në adhurim dhe respekt të Allahut të Madhëruar, një njeri zemra e të cilit është e lidhur për xhamitë, dy njerëz të cilët duhen në emër të Allahut, janë shoqëruar dhe të tillë kanë mbetur gjerë në ndarje (vdekje), një njeri të cilin e ka thirrur një grua me autoritet dhe e bukur, kurse ai e refuzon duke i thënë se i frikësohem Allahut. Një njeri i cili ndan sadaka fshehurazi

ashtu që dora e majtë nuk e din sa ndanë e djathta dhe një njeri që kur në vetmi e përmend Allahun i lotojnë sytë.”(Mutefekun alejhi )

### **O Musliman i nderuar**

Le të jenë nafilet që i kryen sa më të shumta. Prandaj, le të jetë pjesa jote prej nafileve ashtu siç vijon:

1) **Prej Kuranit Fisnik:** Leximi i një xhuzi çdo ditë në mënyre që ta përfundosh leximin e tij për çdo muaj.

2) **Prej lutjeve:** T'i përmbahesh lutjeve të caktuara pas farzeve dhe lutjeve të gjumit, të ushqimit, pijes, udhëtimit, të mëngjesit dhe mbrëmjes etj.

3) **Prej namazeve nafile:** T'i përmbahesh syneteve të rregullta, namazit të Duhasë dhe Vitrit.

4) **Dhe prej sadakas:** Ndarja e një pjese nga paga jote në çdo muaj vazhdimisht që të kontribuosh me të në përhapjen e islamit dhe t'i ndihmosh muslimanët kudo në botë.

5) **Prej agjërimit:** Agjërimi i gjashtë ditëve prej muajit Shewal, ditës së Arafatit , ditës së Ashuras, agjërimi i tri ditëve për çdo muaj dhe le të jene ditët e trembëdhjetë, katërbëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë.

6) **Prej vizitës së shtëpisë së Allahut (Qabes):** Të vizitosh atë kohe pas kohe, ti dhe familja jote duke shfrytëzuar vendin dhe kohën p.sh vizita në Ramazan.

**Allahu u dhuroftë të gjithëve sukses.**